



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1294, datë 11.06.2010

Për

“Miratimin e Dokumentit per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtes se perdorimit ne brezin e frekuencave 1800-1805 MHz”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj.Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 11.06.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin e Dokumentit per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtes se perdorimit ne brezin e frekuencave 1800-1805 MHz”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 1 dhe 2) e Nenit 68 te ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**Ligji nr. 9918**);
2. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar:

V Ë R E N:

1. Dokumentacioni per **“Miratimin e Dokumentit per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtes se perdorimit ne brezin e frekuencave 1800-1805 MHz”** eshte pergatitur ne perputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator perkates.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Duke marrë në konsideratë:

- realizimin e dhenies ne perdorim ne nje kohe sa me te pershtatshme te ketij brezi;
- krijimin e kushteve per nje treg perspektiv konkurent;
- perdorimin ne menyre eficente te brezit te frekuencave te disponueshem;
- realizimin e zgjidhjeve që sjellin përftime më të mëdha për abonentët ne vecanti dhe per ekonomine shqiptare ne pergjithesi;
- realizimin e zgjidhjeve që janë neutrale nga pikëpamja e teknologjisë;
- realizimin e zgjidhjeve që janë plotësisht në përputhje me legjislacionin aktual të BE,

bazuar ne piken 1 dhe 2) te Nenit 68, pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe Pika 17 e nenit 21 të Rregullores së Brendëshme,

V E N D O S:

1. Të miratojë **“Miratimin e Dokumentit per keshillim publik “Mbi dhenien e te drejtes se perdorimit ne brezin e frekuencave 1800-1805 MHz”** sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Keshillimi publik fillon ne daten e publikimit ne mediat e shkruara dhe zgjat 30 dite.

3. Njoftimi për këtë keshillim të botohet në shtypin e përditshëm dhe në faqen e Internetit të AKEP: www.akep.gov.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alketa MUKAVELATI
2. Benon PALOKA
3. Ibsen ELEZI
4. Zamira NURÇE

NJOFTIM PER KESHILLIM PUBLIK

MBI

DHENIEN NE PERDORIM TE BREZIT TE FREKUENCAVE

1800-1805 MHz

I. Hyrje

(1) Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – AKEP, ka kryer nje proces keshillimi publik lidhur me dhenien e te drejtes se perdorimit te frekuencave per te ofruar sherbimin e aksesit me brez te gjere ne 1800-1805 MHz sipas nenit 110 te Ligjit nr. 9918.

Pas marrjes se komenteve te te interesuarve per brezin qe u publikua ne procesin e keshillimit publik AKEP ka menduar te keshillohet edhe per disa ceshtje qe tani kane te bejne konkretisht me brezin 1800-1805 MHz. (Kjo ka qene shprehur edhe ne dokumentin e pare te keshillimit publik).

Me qellim marrjen e vendimeve dhe informacionit nga pale te interesuara AKEP ka formular disa *Pyetje* qe paraqiten ne pjesen e meposhtme:

1. Brezi 1800-1805 MHz

a) AKEP mendon te percaktoje radioparamterat e teknologjive te perdorura ne brezat e mesiperem si:

- fuqine,
- kanalet,
- teknika e modulimit,
- bashkekzistencen e teknologjive te ndryshme dhe variante te te njejtes teknologji,

ne perputhje me standartin ETSI TS 125 105 V8.0.0 (2008-10) *Technical Specification*

Universal Mobile Telecommunications System (UMTS);

Base Station (BS) radio transmission and reception (TDD)

(3GPP TS 25.105 version 8.0.0)

Pyetja:

- *A jeni dakort me sa me sipër? Ne se keni ndonje qendrim tjetër ju lutemi komentini.*

b) AKEP mendon që këto frekuenca do të përdoren për:

- Lidhje me përdoruesin fundor
- Rrjet transmetimi
- Ose të dyja

Pyetja:

- *A jeni dakort me këto përcaktim? Ne se keni ndonje qendrim tjetër ju lutemi komentini.*

c) AKEP mendon se shërbimet të detyrueshme për tu ofruar nga secila teknologji do të jenë:

- Internet me shpejtësi të lartë për përdorues të levizshëm dhe fikse
- Data
- e-government, e-learning, e-commerce, etj

Pyetja:

- *A jeni dakort me këto përcaktim? Ne se keni ndonje qendrim tjetër ju lutemi komentini.*

2. Zbatimi

- a) AKEP mendon të japë një të drejtë përdorimi kombëtare.
- Kufizimi i numrit të të drejtave për të përdorur frekuencat lidhet me brezin e kufizuar në dispozicion të këtij shërbimi dhe me detyrimin e përdorimit sa më efikas të tyre.

b) AKEP mendon se procedura e tenderit publik është mënyra më e drejtë për dhënie në përdorim të këtij brezi:

Pyetja:

- *A jeni dakort me këtë procedurë? Ne se keni ndonje qendrim tjetër ju lutemi komentini.*

c) AKEP mendon të vendosë kushte për kohën e mbulimit me shërbim pas pajisjes me autorizim individual si dhe për shtrirjen gjeografike.

Pyetja:

- *A jeni dakort me keto kushte? Ne se keni ndonje qendrim tjeter ju lutemi komentini.*

3. Cmimi per brezin e frekuencave qe do te jepet ne perdorim

- *Cila eshte vlera qe jeni te gatshem te paguani per kete Autorizim.*

5. Ceshtje tjeter qe mendoni te merret ne konsiderate?